



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipality of Istog

01 Numër: 182/018
Data: 27.04.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 43821

MARRËVESHJE
ME KOMPANIN E UJËSJELLËSIT RAJONAL "HIDRODRINI" NË PEJË PËR
REALIZIM TË PROJEKTIT "NDRRIMI I GYPAVE TË UJËSJELLËSIT NË
GJATËSI PREJ 1100m NGA Rr."SHKOZA" NË ISTOG DERI TË VRREZAT E
FSH. CËRRCË" MË PARTICIPIM

I. PALËT

E lidhur në Istog, më: 27.04.2018, në mes të:

1. Komunës së Istogut, të cilën e përfaqëson, z.Haki Rugova, Kryetari i Komunës, në njëerën anë
- dhe
2. Për Kompaninë e Ujësjiellësit Rajonal "Hidrodrini" në Pejë të cilin e përfaqëson, z.Agron Tigani, Drejtor Menaxhues nga Peja, nga ana tjetër.

II. OBJEKT I MARRËVESHJES

Pika 1

Objekti i kësaj marrëveshje është participimi me mjete financiare i komunës për realizimin e projektit: "Ndërrimi i Gypave të Ujësjiellësit nga Rr. "Shkoza" në Istog deri të varrezat e fsh. Cërcë me gjatësi prej 1100m" në bashkëpunim me KUR "Hidrodrini" për largimin e gypave të vjetër të ujësjiellësit dhe vendosjen e gypave të ri për sigurinë e qytetarëve që të kenë ujë të pijes cilësor.

Hidrodrini ka participuar me gypa për ujësjiellës në shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 6,000.00(gjashtëmijë euro) dhe që kostoja për ndërrimin këtyre gypave të ujësjiellësit është 25,000.00€ më e lartë se sa mjetet të cilat i ka në dispozicion "Hidrodrini", atëherë:

Komuna për realizimin e këtij projekti ka ndarë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 19,000.00€ (nëntëmbëdhjetë mijë euro) nga kodi i programit Nr. 43714 për projektet me participim me komunitetin nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.17517 fondi burimor Nr. 22.

Paramasa dhe parallogaria e projektit është në shumë prej 25,000.00€ (njëzet e pesëmijë euro).

III. OBLIGIMET E KOMUNËS

Pika 2

Komuna përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Që nga buxheti komunal, përkatësisht programi buxhetor i projekteve me participim me komunitetin, komuna ndanë shumën mjeteve financiare në lartësi prej 19,000.00€ (nëntëmbëdhjetë mijë euro) për "Ndërrimin e gypave të ujësjellësit nga Rr."Shkoza" në Istog deri të varrezat e fsh. Cërcë me gjatësi 1100m", sipas paramasës dhe paralogaritë;
- Të udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit në pajtim me Ligjin për prokurimin publik;
- Të caktojë mbikëqyrësin për përcjelljen e realizimit të punimeve;
- Pas njoftimit mbi përfundimin e punimeve të caktoj komisionin për pranimin e punëve dhe një anëtar i komisionit të jetë nga Hidrodrini;
- Të kërkoj nga KUR "Hidrodrini" të sjellë dëshminë për sigurimin e gypave të ujësjellësit në gjatësi prej 300m në Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Të kërkoj nga "Hidrodrini" që të caktoj një përfaqësues i cili do të bashkëpunoj me kryerësin e punëve dhe mbikëqyrësin për realizimin e këtij projekti;
- Të njoftoj Hidrodrinin me fituesin e tenderit; dhe
- Të ofrojë ndihmë përkatëse në realizim të projektit të lartcekur.

IV. OBLIGIMET E KUR "HIDRODRINI"

Pika 3

KUR "Hidrodrini" përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Të dërgojë një përfaqësues gjatë hapjes së tenderit;
- Pas përfundimit të punimeve të caktojë një anëtar në komisionin për pranimin e punimeve;
- Të sjellë dëshminë për sigurimin e gypave të ujësjellësit në gjatësi prej 300m në Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Të eliminojë pengesat e çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit në fjalë;
- Të caktojë një përfaqësues nga komuniteti i cili do të bashkëpunoj me kryesin e punëve dhe mbikëqyrësin e realizimit të projektit në fjalë.

V. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Pika 4

Palët e kësaj marrëveshje do të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë marrëveshje t'i zbatojnë më përpikëri dhe për çdo paqartësi apo vërejtje,

në zbatim të obligimeve të kësaj marrëveshje të komunikojnë në mes veti në formë të shkruar.

VI. NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

Pika 5

Kjo marrëveshje apo një pjesë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet nëse palët për këtë ndryshim apo modifikim pajtohen. Ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe është aneks i kësaj marrëveshje.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

Pika 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më nënshkrimin e saj nga palët në marrëveshje.

Pika 7

Mosmarrëveshjet që lindin pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje palët do të përpiqen t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast të dështimit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve eventuale përmes bisedimeve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata Themelore Pejë - Dega në Istog.


Marrëveshja e lartpërmendur është hartuar në 4 kopje identike njëra me tjetrën, një kopje për KUR "Hidrodrini", një kopje për Drejtorin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe dy kopje mbesin në arkivin e komunës.

PALET NË MARRËVESHJE

PËR KOMUNËN E ISTOGUT

z. Haki RUGOVA
Kryetari i Komunës

Aer





nënshkruar më: 04/05/2018

PËR KUR "HIDRODRINI"

z. Agron Tigani
Drejtor Menaxhues





nënshkruar më: 08/05/2018